



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 546 Prot.

Tiranë, më 19. 04. 2018

V E N D I M

Nr. 107, Datë 19. 04. 2018

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa numër 19, datë 06.02.2018, e P. N., kundër Bashkisë Vlorë, në të cilën pretendon diskriminim *për shkak të racës dhe gjendjes ekonomike*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

P. N. sqaron se është prind i dy fëmijëve dhe jeton në një ndërtesë në kushte shumë të rënuara. Ka shkuar pranë Bashkisë Vlorë për të kërkuar strehim dhe nuk është marrë asnjë masë për strehimin e saj. Përsa më lart, ankuesja pretendon se është trajtuar në mënyrë diskriminuese, nga ana e drejtuesve të Bashkisë Vlorë, për shkak të gjendjes racës¹ dhe gjendjes ekonomike².

Raca dhe gjendja ekonomike, janë shkaqe për të cilat Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

¹ Për shkak se ankuesja i përket komunitetit egjiptian.

² Për shkak se ankuesja është në gjendje të rënduar ekonomike.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vijoi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me anë të shkresës nr. 252 prot., datë 13.02.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, iu drejtua Institucionit të Bashkisë Vlorë, në të cilën kërkoi informacion mbi pretendimet e ankueses, si dhe:

- Kopje të dokumentacionit, nëse ankuesja trajtohet me ndihmë ekonomike nga Bashkia Vlorë.
 - Kopje të dokumentacionit, nëse ankuesja ka paraqitur pranë Bashkisë Vlorë, kërkesë për strehim.
- Në mbështetje të pretendimeve të ankueses, Bashkia Vlorë, nëpërmjet shkresës³ nr. 1258/2 prot., datë 21.02.2018, informoi KMD-në se: “...P. N. ka përfituar dhe vazhdon të jetë përfituese e ndihmës ekonomike pranë Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social Vlorë.”
- Gjithashtu, Bashkia Vlorë, nëpërmjet shkresës⁴ nr. 1258/1 prot., datë 21.02.2018, informoi KMD-në se: “...Në Bashkinë Vlorë rezultojnë të rregjistruara 1600 familje të pastreha, të cilat kanë paraqitur kërkesën në zbatim të ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” të ndryshuar. Duke qënë se Bashkia Vlorë nuk posedon banesa sociale me qira për strehimin e familjeve në nevojë, nga viti 2009 e në vazhdim ka zbatuar me të ardhurat e veta, si një instrument të këtij programi, bonusin e strehimit, për të mbuluar pjesërisht pagesat e qirasë për familjet e pastreha që banojnë me qira në tregun e lirë. Familjet e komunitetit egjiptian, që kanë aplikuar mbi bazën e dokumentacionit dhe plotësimit të kushteve e kriterëve të vendosura në ligj, janë përzgjedhur me përparësi. Çdo vit më shumë se gjysma e familjeve përfituese të bonusit të strehimit i përkasin komunitetit egjiptian. Po kështu, në zbatim të Udhëzimit Nr. 3, datë 08.10.2015 të Ministrisë së Zhvillimit Urban, është zhvilluar faza e parë dhe e dytë për rikonstruksionin e banesave të këtij komuniteti, ku kanë përfituar 53 familje. P. N. ka qënë përfituese e këtij projekti në fazën e parë, për banesën që posedon në lagjen “Partizani” Vlorë. Duhet të sqarohet se në këtë banesë familja e saj banon nën normat e strehimit, por në fazën e parë ishte e pamundur të parashikohej ndërtimi i ambjentëve shtesë, për shkak të mungesës së pronësisë mbi truallin.”

³ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 252/2 prot., datë 26.02.2018

⁴ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 252/1 prot., datë 26.02.2018

Bashkëlidhur shkresave të sipërcituara, Bashkia Vlorë vuri në dispozicion të KMD-së, një kopje të planimetrisë së banesës dhe të preventivit të punimeve, sipas zërave dhe vlerës.

2. Përsa më lart, inspektorët e KMD-së, më datë 08.03.2018, u paraqitën pranë banesës së P. N., për të kryer verifikimet përkatëse mbi çështjen në fjalë.

Gjatë inspektimit pranë banesës së ankueses, inspektorët e KMD-së, konstatuan se një pjesë e banesës së P. N. ishte bërë rikonstruksion së fundmi nga ana e Bashkisë Vlorë. Sipas ankueses, përsa i përket pjesës tjetër të banesës, e cila nuk ishte rikonstruktuar. Ankuesja i bëri me dije inspektorët se familja e saj ishte përfutuese e një projekti të zbatuar nga Bashkia Vlorë, i cili kishte si qëllim rikonstruksionin e pjesshëm të banesave të disa prej familjeve që i përkisnin komunitetit rom të qytetit të Vlorës. Nga kryerja e verifikimeve në banesën e P. N., u konstatua se banesa ishte një shtëpi një katëshe, që përbëhej nga një verandë e vogël, korridori dhe një dhomë. Rreth shtëpisë ndodhej një oborr i vogël dhe një tualet. Nga vëshgimet e drejtpërdrejta rezultoi se banesa kishte lagështirë në ambientet e brendshme⁵, e cila po riparohej aktualisht nga ana e përfaqësuesve të projektit. Inspektorët konstatuan se objekti i ankesës lidhej me një banesë të ndërtuar rreth viteve 1974-1975, për të cilën ajo kërkonte t'i nënshtohet rikonstruksionit nga ana e Bashkisë Vlorë. Lidhur me këtë, Bashkia Vlorë kishte bërë me dije ankuesen se duhet të paraqesë dokumentacionin mbi pronësinë e truallit, në mënyrë që të përfitojë nga projekti për rikonstruksionin e saj. Duke qënë se ankuesja pretendonte se dispononte dokumentacionin mbi pronësinë e truallit, atëherë u kërkua⁶ nga inspektorët të administrohej një kopje e tij dhe u ra dakord që ankuesja ta vërë në dispozicion të KMD-së brenda pak ditëve me anë të postës zyrtare.

Në përfundim, ankuesja kërkoi nga KMD, t'i mundësohet ndihmë financiare.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Mbështetur në provat e administruara nga të dy palët, rezultoi se:

Bashkia Vlorë ka qenë zbatuese e Projektit “Përmirësimi i kushteve të banesave të komunitetit egjiptian të qytetit në Vlorës”, i cili është financuar nga Buxheti i shtetit. Në projekt janë përfshirë 53 familje të përzgjedhura nga Ministria e Zhvillimit Urban.

Mbështetur në dokumentacionin e administruar, rezulton se në banesën e P. N., janë kryer punime në vlerën 200111.3 lekë, të cilat përfshijnë disa lloj rikonstruksionesh duke filluar nga hidroizolimi me emulsion bitumi e deri tek suvatë e zakonshme te fasadës së banesës, vendosjen e dy dyerve

⁵ Në cilësinë e provës, inspektorët e KMD-së disponojnë foto të vendeve me lagështirë

⁶ Cituar edhe në procesverbalin e inspektimit.

duralumin (të specifikuara) lyerje me bojë hidroplastike, shtrim pllakash, e deri tek vënia e shtresave për llustër çimentosh.

Pavarësisht faktit që Komisioneri i kërkoi ankueses kopje të dokumentacionit që vërtetonte pronësinë e banesës së parikonstruktuar nga Bashkia Vlorë, P. N. nuk depozitoi pranë KMD-së asnjë të dhënë lidhur me këtë.

Përsa më lart dhe duke marrë shkas nga ankesa e bërë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi shqyrtoi legjislacionit në fuqi, lidhur me programet e strehimit dhe konstatoi se:

Ligji Nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për Programet Sociale të Strehimit”, i ndryshuar, në nenin 5, ku përcaktohen kriteret e përzgjedhjes së përfituesve nga programet sociale, parashikon se:

“1. Përzgjedhja e familjeve përfituese bëhet sipas një sistemi pikëzimi, me anë të të cilit vlerësohen:

a) Kushtet e strehimit, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi familjet që:

i) nuk disponojnë banesë në pronësi;

ii) banojnë në banesa që paraqesin rrezik shembjeje

iii) banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi;

iv) kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore ose zbatimit të një vendimi gjyqësor.

b) Kushtet familjare, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi rastet e mëposhtme:

i) familjet njëprindërore, që kanë në ngarkim fëmijë;

ii) të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;

iii) familjet me më shumë se katër fëmijë;

iv) çiftet e reja me moshë totale deri në 60 vjeç.

2.

3. *Kur programi zbatohet me financim, të plotë ose të pjesshëm, të Buxhetit të Shtetit, ministria, që mbulon çështjet e strehimit, në raport me masën e financimit dhe në bashkërendim dhe në marrëveshje me kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore përkatëse, mund të kushtëzojë një sistem pikëzimi, që favorizon kategori, të cilat kanë përparësi në politikat kombëtare, si personat me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore deri në moshën 30 vjeç, personat me aftësi të kufizuara, punëtorët emigrantë, emigrantët e rikthyer, familjet e policëve të rënë në detyrë. Marrëveshja, përveç sistemit të pikëzimit, për kategoritë e sipërpërmendura, përfshin edhe angazhimin për mbulimin e shpenzimeve, sipas pikës 2 të nenit 24 të këtij ligji.”*

Përsa më lart, programet sociale strehimi janë “programe, të cilat shërbejnë për strehimin e familjeve dhe të individëve, që nuk janë në gjendje ekonomike e sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave”. Në të përcaktohen tre programe sociale strehimi: banesat sociale me qira, banesat me kosto të ulët dhe programi i pajisjes së truallit me infrastrukturë. Përfituesit e

programeve sociale të strehimit duhet të përmbushin njërin prej kritereve të mëposhtme: nuk kanë në pronësi një banesë; zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit; ose kanë mbetur të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore (Ligji nr. 9232, neni 4). Përzgjedhja e përfituesve mbështetet tek kushtet e tyre të jetesës si edhe tek rrethanat e tyre shoqërore dhe ekonomike. Përparësi u jepet 15 grupeve, përfshirë familjet me një prind të vetëm, familjet e mëdha, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuar, çiftet e reja, familjet që kanë ndryshuar vendqëndrim, jetimët, emigrantët e rikthyer, punëtorët migrues, azilkërkuesit, oficerët e rënë në detyrë, viktimat e dhunës në familje, familjet rome, familjet egjiptiane dhe përfituesit e ndihmës ekonomike.

Në të njëjtën frymë qëndron edhe Udhëzimi Nr. 3, datë 08.10.2015 “Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme të zbatimit të programit të banesave me kosto të ulët për komunitetin rom dhe egjiptian”, në të cilën i jepet përparësi kategorive të familjeve përfituese të i përkasin komunitetit rom dhe atij egjiptian.

Refruar politikave të hartuara nga qeveria dhe Bashkia Vlorë, shihet që për familjet e komunitetit rom/egjiptian të qytetit të Vlorës, është zbatuar projekti për ndërtimin e banesave dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për këto komunitete. Ankuesja trajtohet me ndihmë ekonomike nga Bashkia Vlorë dhe ka përfituar nga projekti për rikonstruksionin e banesave të komunitetit rom/egjiptian, për një pjesë të ndërtesës që ka në pronësi. Komisioneri gjykon se, fakti që ankuesja nuk ka përfituar nga projekti për rikonstruksionin e pjesës tjetër të banesës, lidhet me mungesën e pronësisë mbi truallin në të cilin ajo ka ndërtesën dhe jo me trajtimin në mënyrë më pak të favorshme nga ana e Bashkisë Vlorë.

Në këtë kontekst, referuar nenit 7, pika 1⁷, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërcituara, Komisioneri gjykon se, pretendimet e shtetasës P. N., se raca dhe gjendja ekonomike janë bërë shkak për trajtimin në mënyrë të pabarabartë dhe të padrejtë, nuk mbështetet në asnjë nga provat dhe faktet e administruara nga Komisioneri gjatë procedurave hetimore.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

⁷ Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, P. N., për shkak të racës dhe gjendjes ekonomike, nga ana e Bashkisë Vlorë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Raca dhe gjendja ekonomike)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)